



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 734/6 prot.

Datë 01.04.2025

V E N D I M
Nr. 427/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fioorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergji Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” P.F. në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 17.02.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Ervin Luzi” P.F. me NIPT K71707007Q dhe adresë: Lagjja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Gucia, Godina nr.5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara
Adresa: “Rexhit Çollaku” Nd.337, Tiranë.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.01.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt:

“Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 17.02.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

.

II.2. Në datën 17.02.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 27.02.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Ervin Luzi P.F.	18,843,300 lekë	Skualifikuar
InfoSoft Office SHPK	19,451,500 lekë	Kualifikuar
AN&RA SHPK	19,774,595 lekë	Kualifikuar
GENTIAN HORIETI P.F.	19,957,800 lekë	Skualifikuar
Naim Hysi P.F.	20,038,460 lekë	Skualifikuar
MALBERTEX SHPK	24,015,912 lekë	Skualifikuar
LIBRARI DYRRAHU SHPK	24,500,000 lekë	Kualifikuar
ARTEO 2018 SHPK	25,296,000 lekë	Kualifikuar
FILARA SHPK	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar

II.4. Në datën 06.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 17.03.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5144 dhe me nr. protokolli 734/2025, datë 17.03.2025, e operatorit ekonomik “Ervin luzi”P.F., duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 734/1 datë 18.03.2025, lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “Ervin Luzi”P.F., mbi shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt - ankim.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumentave si subjekt i interesuar në kuptim të nenit 113, të

ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, formular i cili është protokolluar me tonën me nr.734/2 prot., datë 21.03.2025

.II.8.Nëpërmjet shërbimit postar autoriteti kontraktor me shkresën nr.245/16 prot., datë 26.03.2025, protokolluar me tonën me nr.734/3 prot., datë 27.03.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e komisionit të shqyrtimit të akteve (KSHA), nr.245/15 prot., datë 26.03.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Ervin Luzi” P.F. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Ervin Luzi” P.F, për kundërshtimin e skualifikimi të ofertës së tij me arsyet: “ *O.E nuk plotëson kriterin 2.2.2 të seksionit: 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pasi pasqyrat financiare (bilanci) për vitin 2021 i dorëzuar në SPE, nuk rezulton të jetë paraqitur në organet kompetente tatimore* ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 8 “*Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit*”, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2, pjesë e dokumenteve të tenderit, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

III.1.2. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Ervin Luzi” P.F ka ngarkuar:

1. Dokumentin me emërtimin “*Bilanci 2023*”,
2. Dokumentin me emërtimin “*Bilanci 2022*”;
3. Dokumentin me emërtimin “*Bilanci 2021*”;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.4. Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, thuhet shprehimisht: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit

dhe pasivit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entitetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”

III.1.6 .KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, edhe kopje të certifikuara të bilanceve të viteve (2021,2022,2023), të paraqitura dhe të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të shoqëruara me Akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik ankimues “Ervin Luzi”P.F. ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi, pra Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2021, Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2022, Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2023,

Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, kriterit 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, si dhe skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Ervin Luzi”P.F me arsyen se O.E nuk plotëson kriterin 2.2.2 të seksionit: 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pasi pasqyrat financiare (bilanci) për vitin 2021 i dorëzuar në SPE, nuk rezulton të jetë paraqitur në organet kompetente tatimore”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “ Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është

mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik.

Gjithashtu, lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues me arsyen se: *pasqyrat financiare (bilanci) për vitin 2021 i dorëzuar në SPE, nuk rezulton të jetë paraqitur në organet kompetente tatimore ”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ka dhënë një indicie që plotëson kriterin 2.2.2 dhe se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik. Sa më sipër, nëse autoriteti kontraktor kishte dyshime lidhur me dokumentacionin e dorëzuar duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Ervin Luzi”P.F. qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Ervin Luzi”P.F, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.01.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësim të ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Ervin Luzi”P.F. në përputhje me konstatimet në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ervin Luzi”P.F..
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri